



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS

**Njoftim Për Shtyp**

**Rasti: Përfitim i kontrollit të shoqërisë Magneti Marelli S.p.A. nga shoqëria CK Holdings Co.,LTD.**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, me shkresën Nr. 660 Prot., protokoll i AK, datë 19.11.2018 “Konfirmim i depozitimit të dokumenteve”, është njoftuar transaksioni i blerjes së shoqërisë Magneti Marelli S.p.A. nga shoqëria CK Holdings Co.,LTD.

Referuar “Marrëveshje për blerje aksionesh” palët në marrëveshje janë:

**Pala blerëse: CK Holdings Co.,LTD**, është një shoqëri e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Japonisë. Qëllimi i shoqërisë CK Holdings Co.,LTD, është të veprojë dhe menaxhojë kompanitë që angazhohen duke mbajtur aksionet tyre në bizneset e prodhimit dhe shkëmbimit të ngrohjes, prodhimi dhe shitja e komponentëve dhe furnizimeve për automobila, prodhimi dhe shitja e pjesëve të automobilave që grumbullojnë makineritë, etj.

**Pala shitëse: Fiat Chrysler Automobiles N.V** është një shoqëri publike holandeze me përgjegjësi të kufizuar dhe ka në zotërim të gjitha aksionet e emetuara dhe të papaguara të zakonshme të Magneti Marelli S.p.A. dhe 99.99% të aksioneve me përparësi të Magneti Marelli S.p.A.

**Target: Magneti Marelli S.p.A.** është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Italisë. Objekti i shoqërisë Magneti Marelli S.p.A. është ushtrimi direkt apo indirekt nëpërmjet shoqërisë ose enteve pjesëmarrëse të aktivitetit projektues, produktiv dhe tregtar në sektorët e industrisë mekanike, elektromekanike, elektronike, kimike, të tërheqjes dhe të shtytjes dhe në veçanti të prodhimit dhe tregtimit komponentëve, detajeve, pjesëve të këmbimit dhe aplikimit për industrinë e automobilave, aksesorët dhe produktet për automjeteve etj.

Shoqëria Magneti Marelli S.p.A. aktualisht kontrollohet nga shoqëria Fiat Chrysler Automobiles N.V.

Në datë 20 tetor 2018 është lidhur “Marrëveshja për blerje aksionesh”, Projekti Gamma, ndërmjet shoqërisë CK Holdings Co.,LTD ( blerësi), Magneti Marelli S.p.A (target) dhe Fiat Chrysler Automobiles N.V (shitësi).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**